



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
URDHËR

Nr. 53/1, Datë 24.03.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 53, DATË 11.03.2020 “
“PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË DHE
ZHVILLIMIN E MBLEDHJEVE APO SEANCAVE DËGJIMORE”**

Mbështetur në (i) Vendimin e datës 09.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, në kushtet kur është deklaruar edhe mbyllja e të gjitha institucioneve arsimore në mbarë vendin, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, (ii) Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr.2 dt. 11.03.2020 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.15/2016, “per parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe semundjeve infektive”, (iii) Aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr.3 dt. 15.03.2020 “Per marrjen e masave të vecanta administrative gjate kohezgjatjes se periudhes se infeksionit te shkaktuar nga Covid – 19”, iv) Aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr.8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr.3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID - 19”, v) Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.03.2020 me ane të se ciles është vendosur “për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe me autoritetin e dhënë nga Ligji nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar

VENDOSA

1. Ndryshimin e afatit të përcaktuar sipas Pikës nr. 3 të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020 “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, si vijon:

Kohëzgjatja e pezullimit, parashikuar në pikën 1 të këtij urdhëri, të jetë deri në perfundimin e epidemisë së shkaktuar nga virusi Covid 19 dhe perfundimin e masave të marra nga Qeveria Shqiptare për këtë qëllim dhe perfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë


